



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 77 prot.

Kamëz, më 17.06.2022

V E N D I M
Nr. 64.Datë 17/06 2022
M B I

“MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË KAMËZ DHE WORLD VISION PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “SISTEMIMI I SHESHIT PRANË SHKOLLËS ARBËRIA”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.06.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.61 Datë 14.06.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.8788/2001 “Për organizatat jo fitimprurëse” (i ndryshuar), **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe World Vision për zbatimin e projektit: “Sistemimi i sheshit pranë shkollës Arbëria”.
2. Miratimin e buxhetit prej 4.458.670 (**katër milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë**) lek. Bashkia Kamëz do të financojë përkatësisht 2.229.335(dy milion e dyqind e njëzet e nëntë e treqind e tridhjetë e pesë) lek dhe Ëord Vision do të financojë 2.229.335 (dy milion e dyqind e njëzet e nëntë e treqind e tridhjetë e pesë) lek.
3. Struktura buxhetore Gr. 0 Prog. 09120 Kap.5 Art.231
4. Ky fond është miratuar në buxhetin e bashkisë me VKB nr. 42 datë 29.03.2022 “Për një ndryshim në VKB nr.132 datë 22.12.2021 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024.”
5. Për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Integritimit në BE dhe Projekteve të Huaja.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Kryetar Këshilli
Hysen KOLDASHI